



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

**NJOFTIM PUBLIK**

Në kuadër të mbështetjes për mësuesit, ju bëjmë me dije se, bazuar në Ligjin nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar, Vendimin nr. 468, datë 26.7.2023 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me kredi të lehtësuar të të punësuarve në administratën publike për blerjen e banesës” dhe në Vendimin nr. 400, datë 19.6.2024 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kuotave të përgjithshme të kredive të reja për kategoritë prioritare të të punësuarve përfitues në administratën publike”, për **vitin 2024** janë miratuar **30 kuota** për trajtimin me kredi të lehtësuar, për blerjen e banesës për kategorinë prioritare mësues në institucionet arsimore parauniversitare publike.

**Ftohen të gjithë mësuesit e sistemit arsimor parauniversitar publik, me kontratë pune me afat të pacaktuar (definitivë), të aplikojnë nëpërmjet portalit e-Albania, deri më 14 gusht 2024, në linkun si më poshtë:**

[https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service\\_code=15809](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=15809)

Përfituesit përzgjidhen nga Komisioni i Vlerësimit, i ngritur pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në bazë të sistemit të pikëzimit, të përcaktuar në Vendimin nr. 469, datë 26.7.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kuotave të përgjithshme të kredive të reja për kategoritë prioritare të të punësuarve përfitues në administratën publike”, brenda **10 ditë pune** nga afati i mbylljes së aplikimeve.

<b>KRITERET E PIKËZIMIT</b>	
<b>KUSHTET E STREHIMIT</b>	<b>50</b>
1. Nuk dispononi banesë në pronësi.	20
2. Banoni në një banesë të mbipopulluar, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.	5
3. Punonjës, që ka humbur banesën si pasojë e zhvendosjes nga zbatimi i një vendimi gjyqësor.	5
4. Punonjës, që banon në një banesë që do të prishet pasi përjashtohet nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike, si dhe nuk përfiton një banesë tjetër.	10
5. Punonjës që banon në banesa rrezik shembjeje, që ka mbetur ose rrezikon të mbetet i pastrehe, si rezultat i fatkeqësisë natyrore.	10
<b>KUSHTET FAMILJARE/SOCIALE/PUNËSIMI</b>	<b>50</b>
1. Punonjës arsimor, i cili në momentin e aplikimit, është i punësuar me kohëzgjatje të pacaktuar në institucionet publike të arsimit parauniversitar.	20

2. Punonjës i cili i përket kategorisë “Familje e re”, në kuptim të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar, ku të dy bashkëshortët/bashkëjetuesit janë punonjës arsimorë.	10
3. Punonjës i cili punon jashtë vendbanimit mbi 100 kilometra larg e që qëndron në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku ndodhet institucioni publik i arsimit parauniversitar, ku punon.	20

<b>KRITERET E PIKËZIMIT NË RAST TË BARAZIMIT TË PIKËVE</b>	
<b>A. KUSHTET FAMILJARE</b>	<b>30</b>
1. Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë ku përfshihen edhe vajzat nëna	6
2. Përbëhen nga familje që kanë në ngarkim persona me aftësi të kufizuar apo persona në pension.	5
3. Familjet me më shumë se katër fëmijë.	4
4. Çifte të reja/të rinj me moshë jo më të madhe se 35 vjeç. Familje të reja ku çifti i bashkëshortëve ka moshë të përbashkët totale deri 70 vjeç.	15
<b>B. KUSHTET EKONOMIKE</b>	<b>12</b>
1. Të paturit pasuri të luajtshme në pronësi, me vlerë nën ½ e shumës së vlerës përkatëse të banesës, për të cilën do të përfitojë kredi të lehtësuar.	3
2. Të paturit pasuri të luajtshme në pronësi, me vlerë nën ¼ e shumës së vlerës përkatëse të banesës, për të cilën do të përfitojë kredi të lehtësuar.	4
3. Të paturit pasuri të luajtshme në pronësi, me vlerë nën 1/8 e shumës së vlerës përkatëse të banesës, për të cilën do të përfitojë kredi të lehtësuar.	5

Në rast se rezultojnë më shumë kandidatë me pikë të barabarta sesa kuotat e përcaktuara në Vendimin nr. 400, datë 19.6.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kuotave të përgjithshme të kredive të reja për kategoritë prioritare të të punësuarve përfitues në administratën publike”, përzgjedhja e tyre do të realizohet me short të përcaktuar nga MAS, në prani të të gjithë anëtarëve duke siguruar edhe filmimin e procesit.